



Pranuar / Dorezuar Primjen / Prodato Received / Delivery	12 . 10	2023	3	viti god year
Organ /Njesia Organ /Jedinica Org./Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity	
SKONSTRUKC	6524	2023	114	



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.1163/2023

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës - Kolegji për shqyrtimin e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar Ardita Haxhnikaj-Demi dhe Jeton Koca-anëtarë, me Çlirim Zeka - Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, duke u bazuar në Aktgjykimin A.nr.143/2023 të datës 06.09.2023 të Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative kanë shqyrtuar ankesën A. nr. 431/2021 të datës 21.05.2021, të parashtruar nga grup ankuesish

të cilët me autorizim i përfaqëson avokati Ilir Rogova rr. "Skënderbeu" nr.74 Gjakovë si dhe ankesën A.nr. 430/2021 të datës 21.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish Kaçun Lima, të cilët me autorizim i përfaqëson

Rogova rr. "Skënderbeu" nr.74 Gjakovë, kundër organit të punësimit Agjencia e Menaxhimit Emergjent, në çështjen juridike "Kompensim Material", duke vepruar në pajtim duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 nenin 16 paragrafin 3, nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 12.10.2023, mori këtë:

V E N D I M

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A. nr. 431 të datës 21.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish si dhe ankesën A.nr. 430/2021 të datës 21.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish dhe e parashtruar nga grup ankuesish të cilët me autorizim i përfaqëson

Lënda i dërgohet për shqyrtim dhe vendosje Komisionit për Ankesa të Nëpunësve të Shërbimit Publik në Agjencinë për Menaxhimin e Emergjencave.

A r s y e t i m

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës ka nxjerr vendimin me numër A.nr.431/2021 me datë 13.12.2022 me numër protokolli 8024/2022 me të cilin Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, shpallet jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën A.nr.431 të datës 21.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish Afërdita Koci, Agron Firza, Ali Abrashi, Bekim Zherka, si dhe ankesën A.nr.430/2021 të datës 21.05.2021 të parashtruar nga grup ankuesish [redacted], e parashtruar nga grup ankuesish.

Ankuesit kundër vendimit të Këshillit me numër A.nr.431/2021 të datës 13.12.2022 kanë ndjekur procedurat e tjera, duke iniciuar konflikt administrativ pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative. Gjykata Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me datën 06.09.2023 ka nxjerr Aktgjykimin me numër A.nr.143/2023, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 15.09.2023 sipas të cilit ka aprovuar kërkesëpadinë e paditësve me të cilin ka anuluar vendimin me numër A.nr.431/2021 të datës 13.12.2022 dhe ka kthyer çështjen në rishqyrtim dhe rivendosje duke detyruar Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës që në procedurë të rivendosjes të udhëzojë palët paditëse se në cilin organ/institucion të drejtohen në lidhje me realizimin e të drejtës së tyre, në afat prej tridhjetë (30) ditësh nga dita e pranimit të këtij vendimi.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Ankesën me nr. Protokolli 2532/2021 të datës 21.05.2021 e parashtruar nga grup ankuesish përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 22.11.2021; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.2790/21, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 15.11.2022; Ankesën me nr. Protokolli 2531/2021 të datës 21.05.2021 e parashtruar nga grup ankuesish përmes përfaqësuesit të autorizuar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Ankesën e datës 22.11.2021; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë Departamenti për Çështje Administrative me numër A.nr.143/2023, i njëjti në Këshill është pranuar me datë 15.09.2023;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave pasi ka shqyrtuar provat e lartshënuara të bashkëngjitur nga ankuesit ka konstatuar se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, është jo kompetent për të vendosur lidhur me ankesën e ankueseve.

Bazuar në [redacted] Kolegji ka gjetur se ankuesit e poshtë shënuar janë të punësuar në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent në kuadër të Ministrisë së Punëve të Brendshme. Ankuesja [redacted] e punësuar në pozitën "Zjarrfikës", ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zjarrfikës", ankuesi Ali Abrashi i punësuar në pozitën "Zjarrfikës", ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zjarrfikës", ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Ndhimës Komandant për punë operative", ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zjarrfikës", ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Zjarrfikës" dhe ankuesi [redacted] i punësuar në pozitën "Komandant i Brigadës së Zjarrfikës".

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave lidhur me kompetencën e shqyrtimit të lëndës, ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, neni 2 paragrafi 1 dhe 2 përcakton se: "Me këtë ligj rregullohet marrëdhënia juridike ndërmjet shtetit dhe zyrtarëve publikë. Zyrtarë publikë janë: Nëpunësi i Shërbimit Civil (në tekstin në vijim: nëpunësi civil); Nëpunësi i Shërbimit Publik; Nëpunësi i Kabinetit; dhe Nëpunësi administrativ dhe mbështetës" përkatësisht neni 2 paragrafi 4 i të njëjtit ligj ka përcaktuar se: Nëpunës i Shërbimit Publik - është personeli i nivelit të lartë drejtues, drejtues, profesional dhe i shërbimeve të brendshme në administratën e shërbimeve publike, pjesë e administratës shtetërore apo në administratën e shërbimeve publike, pjesë e një komune të cilët ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta për qytetarët në fushën e arsimit, shëndetësisë, kulturës, artit si dhe shërbime tjera të ngjashme publike", gjithashtu Kolegji ka pasur parasysh edhe autorizimet e Zjarrfikësve gjegjësisht nenin 14 të Ligjit nr. 04/L-049 ku përcaktohet se "Autorizimi i Njësisve të Zjarrfikjes dhe Shpëtimit në detyrë 1. Komandantët janë të autorizuar për dhënien e urdhrave njësisve të tyre të zjarrfikjes dhe shpëtimit si në vijim: 1.1. të hyjnë në banesë apo në shtëpi pa pëlqimin e pronarëve nëse ekzistojnë shkaqet që paraqesin rrezikshmërinë për njerëzit dhe pasurinë e tyre; 1.2. të ndalojnë qarkullimin e automjeteve, praninë e personave të pa autorizuar në vendngjarje ku bëhet intervenimi derisa të arrij policia; 1.3. të njoftojnë policinë për të siguruar vendin e ngjarjes dhe ndërmarrjen e masave të tjera për evitimin e dëmeve dhe pasojave që mund të ndodhin; 1.4. të evakujnë dhe largojnë personat dhe gjësendet nga vendi i ngjarjes si dhe përreth tyre, të cilat janë të rrezikuara nga zjarri i shkaktuar; 1.5. të ndërprejnë furnizimin me energji elektrike, gaz dhe burime të tjera të energjisë; 1.6. të ndërprejnë pjesërisht ose tërësisht rrjetin e ujësjetës në zonën apo vendbanimin ku ka ndodhur zjarri, me qëllim të sigurimit të sasisë së nevojshme të ujit për shuarjen e zjarrit; 1.7. shfrytëzojnë ujin nga të gjitha burimet, pa marrë parasysh se kujt i përket pa ndonjë kompensim; 1.8. të rrënojnë pjesërisht apo tërësisht objektet nga ana e të cilit mund të përhapet zjarri, nëse përhapja e tij nuk mund të evitohet në ndonjë mënyrë tjetër; 1.9. të shfrytëzojnë mjetet e tjera të transportit për bartjen e personave të lënduar nga vendi i ngjarjes deri në Qendrën Shëndetësore më të afërt"

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave bazuar në shkresat e lëndës dhe bazuar në legjislacionin e potencuar si më lartë konstatoi se pozitat e ankuesve hynë në kategorinë e nëpunësve të Shërbimit Publik ,ndërsa në kuptim të nenit 101 paragrafi 2 të Kushtetues së Republikës së Kosovës si dhe nenit 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Këshilli është kompetent që të shqyrtoj dhe të merr vendime vetëm për ankesat e nëpunësve civil dhe kandidatëve për pranim në Shërbimin Civil.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave me faktin se konstaton jo kompetencën në këtë lëndë përkatësisht ankesë dhe ndërlidhur me procedurën e ushtrimit të mjeteve juridike në mbrojtje të drejtave nga marrëdhënia e punës të nëpunësve të shërbimit publik ju referua Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë përkatësisht nenit 24 paragrafi 4, ku parashihet: "Nëpunësi i Shërbimit Publik dhe nëpunësi administrativ dhe mbështetës kanë të drejtë të ankohen sipas këtij ligji te punëdhënësi dhe më pas mund të fillojë kontest administrativ në gjykatën kompetente" dhe nenit 74 të po të njëjtit ligj ku shprehimisht parashihet: "1.Zyrtari i shërbimit publik mund të ankohet te punëdhënësi kur pretendon se i janë shkelur të drejtat në marrëdhënien e punës. Të drejtën e ankimit e kanë dhe kandidatët në procedurën e konkurrimit. 2.Ankimimi paraqitet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga njoftimi i vendimit. 3.Shqyrtimi i ankesave është në kompetencën e Komisionit të Ankesave. Komisioni i Ankesave krijohet: 3.1. në çdo administratë të institucionit të shërbimit publik; 3.2.në çdo ministri për administratën e njësisë të Shërbimit Publik në kompetencë të administratës



shtetërore; dhe 3.3.në çdo komunë për nëpunësit e administratës së njësisë së shërbimit publik në kompetencë të komunës. 5.Ankesa shqyrtohet brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve nga paraqitja e saj. Ankuesi, nëse nuk është i kënaqur me vendimin e organit të ankimit apo në rast se nuk merr përgjigje brenda afatit të përcaktuar në pajtim me paragrafin 4 të këtij neni, në afatin vijues prej pesëmbëdhjetë (15) ditëve, mund të iniciojë kontest pune në gjykatën kompetente”.


Andaj duke pas parasysh konstatimin si më lartë se Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës nuk ka juridiksion për të vendosur lidhur me ankesën me numër A.nr.431/2021 të datës 21.05.2021 si dhe ankesën A.nr. 430/2021 të datës 21.05.2021, dhe meqenëse nga shkresat e lëndës vërehet se ankuesit nuk kanë shfrytëzuar mjetet juridike në procedurë administrative pranë organit punëdhënës komfor dispozitave të legjislacionit të potencuar si më lartë, dhe duke u bazuar në nenin 75 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative vendosi që lënda ti dërgohet për shqyrtim dhe vendosje organit kompetent, në këtë rast Komisionit për Ankesa në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.8 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në gjykatën kompetente, Gjykatën Themelore në Prishtinë/ Departamenti për Çështje Administrative brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
LËNDA NR. A.Nr.1163/2023

Çlirim Zeka

Procesmbajtës



Vendimi i dërgohet:

Avokatit

Drejtorit të Agjencionit të Menaxhimit Emergjent;

Komisionit të Ankesave në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;

Udhëheqësit të Personelit në Agjencinë e Menaxhimit Emergjent;

Arkivit të KPMSHCK-së.

